



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

**Hapet thirrja për mobilitet (bursë) stafi të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në Università degli Studi di Trento, Itali.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikim për bursë për mobilitet për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Università degli Studi di Trento, Itali.

Lloji i mobilitetit përfshin: Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie dhe trajnim.

Kohëzgjatja e bursës: 5 ditë + 2 ditë udhëtimi

Numri total i stafit: 4 (2 për mësimdhënie dhe 2 për trajnim)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie, ose trajnim, për stafin:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve.
- Certifikata e gjuhës së huaj (Niveli minimal i gjuhës angleze B2)
- Aprovim nga Përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës**;
- Dokumenti i Mobility Agreement (“Staff Mobility for Teaching” or Staff Mobility for Training”) për stafin akademik/administrativ në universitetin pritës***;

**Plani i mobilitetit për mësimdhënie (teaching) ose trajnim (training), si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin akademik, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga Përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf akademik në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/ Titullar Departamenti ose program studimi/ Profesor), për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës ose research gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aproves, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement për Teaching (mësimdhënie) or Training (trajnim) për stafin akademik/administrativ është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga Përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarte e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 30 Prill 2022

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al ose rkodra@upt.al.